



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**PROJEKTVENDIM**

Nr.\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**“MBI PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR TË DREJTËN E KALIMIT  
PER RRJETET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE TË  
RREGULLAVE PËR MËNYRËN DHE AFATIN E PAGIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 35, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, Këshilli i Ministrave me bashkëpropozimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë,

**V E N D O S I:**

1. Përcaktimin e tarifës për të drejtën e kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe përcaktimin e rregullave për mënyrën dhe afatin e pagimit.
2. Tarifa e së drejtës së kalimit për shtrimin e tubacioneve, kablllove për rrjetet e komunikimeve elektronike në autostrada, rrugë interurbane, dhe lokale, llogaritet sipas Tabelës 1, dhe tarifa për vendosje të pajisjeve dhe përdorim të pronës publike, llogaritet për njësi të sipërfaqes sipas Tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifa për të drejtën e kalimit paguhet nga sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike në bazë vjetore ose “one fee” dhe sipas kategorive të pronës publike ku do të kryhen punimet.
4. Tarifa vetëm për vitin e parë të fitimit të së drejtës së kalimit do të jetë proporcionale me kohën e marrjes së lejes dhe do paguhet për periudhën e mbetur të vitit.

5. Me qëllim arritjen e objektivave të “Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2021-2025” :
  - a. Në zonat ku mungon infrastruktura e rrjetit të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, e drejta e kalimit për sipërmarrësit, të cilët duan të ndërtojnë rrjet të komunikimeve elektronike në pronën publike, do të ofrohet pa pagesë për tre vitet e para të ushtrimit të kësaj të drejte.
  - b. Në zonat me penetrim të broadbandit fiks, për familje me më pak mesatarja evropiane, e drejta e kalimit për sipërmarrësit, të cilët duan të ndërtojnë rrjet të komunikimeve elektronike në pronën publike, do të ofrohet pa pagesë.
  - c. AKEP përditëson çdo vit të dhënat për penetrimin e broadbandit fiks sipas bashkive dhe të mesatares evropiane.
6. Tarifa vjetore për të drejtën e kalimit paguhet nga sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike tek autoriteti përgjegjës për dhënien e së drejtës të kalimit ,brenda muajit mars të çdo viti.
7. Autoritetet përgjegjëse për dhënien e së drejtës së kalimit mund t’i imponojnë sipërmarrësit të rrjetit të komunikimeve elektronike, tarifë për kostot administrative, lidhur me procesin e aplikimit për lejen dhe monitorimin e punimeve.
8. Ngarkohen organet e qeverisjes qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**Tarifat për të drejtën e kalimit**

- I. Tarifa e të drejtës së kalimit që lidhet me zënien apo përdorimin e hapësirës së rrugës, me qëllim instalimin e tubave, elementëve të infrastrukturës pasive të rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë në rrugët shtetërore, vendoset nga enti pronar i rrugës jo më e lartë se 10% e investimit përkatës nga subjekti kërkues për shtrirjen e këtij rrjeti. Kjo tarifë është “one fee”.
- II. Tarifa për përdorimin/zënien e hapësirës publike me qëllim instalimin e elementëve të infrastrukturës pasive të rrjeteve të komunikimit elektronike të shpejtësisë së lartë janë sipas Aneksit 6 të legjislacionit në fuqi për taksat dhe tarifat vendore si më poshtë.

<b>Mjedisi i aksesit</b>	<b>Tarifa mujore minimale për m<sup>2</sup> hapësirë</b>
Bashki-qytet Zona I	120
Bashki-qytet Zona II	90
Bashki-qytet Zona III	60

Shënim: Për njësitë administrative në bashkitë jo qendër rrethi, niveli tregues i taksës për çdo zonë të treguar në tabelë është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës.  
Tabela e mësipërme është subjekt i rishikimit me ndryshimet në legjislacionin për taksat dhe tarifat vendore.